REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 36/17
Datë/Datum. 20.03.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEË BODY

PSH Nr. 36/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej: z. Goran Milenković - Kryetar, z. Blerim Dina - Referues, z. Nuhi Paçarizi- Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga OE "Artius Group" Sh.p.k – Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me Medalje'', me nr prok: "102/16/124/121'' iniciuar nga AK–së /Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës/ më datën 13 mars 2017, mori këtë:

V E N D I M

I. **Hedhet,** poshtë si e palejuar ankesa e OE "Artius Group" Sh.p.k – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me Medalje''me nr prok: "102/16/124/121", iniciuar nga autoriteti kontraktues /Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës / për shkak të mungesës së interesit juridiko-material konform nenit 111 paragrafi 1.5 dhe 1.8 përkitazi me nenin 4 paragrafi 1.26 i LPP-së.

II. **Vërtetohet,** njoftimi për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me Medalje'', me nr prok: "102/16/124/121'', iniciuar nga AK-së / Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës /

III. Operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e sigurimit të ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, pasi që ankesa është hedhur poshtë si e palejuar.

IV. Autoriteti kontraktues në afat prej 10 ditësh, duhet ta informojë me shkrim Panelin shqyrtues, për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit dhe palët tjera në procedurë.

V. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 36 pika 5 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Njoftimi për kontratë është bërë me dt:20.10.2016, ndërsa hapja e ofertave është bërë me dt:14.11.2016, ku kanë marr pjesë dy operatorë ekonomik.

Njoftimi për dhënie të kontratës është bërë me dt:21.11.2016, ku është rekomanduar për dhënie të kontratës operatori ekonomik N. T. SH. P" Coin"-Prishtinë.

Kërkesa për rishqyrtim nga ana e operatorit ekonomik "Artus Group" Sh. p. k – Prishtinë është bërë me dt:27.01.2017.

Me dt:30.01.2017 autoriteti kontraktues ka marr vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Artius Group" Sh. p. k – Prishtinë

Operatori ekonomik "Artius Group" Sh.p.k – Prishtinë, si palë e pakënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me datën 03 shkurt 2017 me nr. protokolli 36/17, kundër vendimit të AK-së përkitazi me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me Medalje''me nr prokë."102/16/124/121'' duke pretenduar se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje esenciale të dispozitës së LP04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, me Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, siç janë:

- Neni 7: Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi.
- Neni 59: Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
- Neni 60: Kriteret për Dhënien e Kontratës.

- Shkelja e ligjit nr. 04/l-070: për dhënien e dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës, përkatësisht nenit 16

Organi Shqyrtues i Prokurimit, pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113 të LPP-së, ka autorizuar ekspertin e OSHP-së, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Ekspertja shqyrtuese përmes raportit të datës 24 shkurt 2017, bazuar në konstatimet e cekura në ekspertizë, ka menduar që Autoriteti Kontraktues- "Zyra e Presidentit", për aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me Medalje'' me nr prok "102/16/124/121'', i ka respektuar në tërësi dispozitat e LPP-së. Prandaj ekspertja shqyrtuese i propozon panelit shqyrtues që vendimi i AK-së të aprovohet, ndërsa ankesa e OE ankues të hedhet poshtë si e palejuar, pasi që OE ankues është palë pa interes në këtë aktivitet të prokurimit.

Operatori ekonomik ankues me datë 06 mars 2017, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertes shqyrtuese.

Autoriteti kontraktues me datë 02 mars 2017, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertes shqyrtuese.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 13.03.2017, ku kanë qenë prezent, paneli shqyrtues, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues, përfaqësuesi i operatorit ekonomik ankues, ekspertja shqyrtuese dhe vëzhguesit e OJQ-së "D Plus", ku u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, njoftimi për dhënie të kontratës,vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE ankues"Artius Group" ka deklaruar: Janë dy pretendime ankimore ku mendojmë se është bërë shkelje në vlerësim. Kriteret që vet ka caktuar AK tek pika 3 ku thuhet "medalja duhet të jetë 3 deri 5mm – Trashësia medaljes", kurse OE i rekomanduar për kontratë nga AK ka dërguar medalje 5.2 mm, ka tejkaluar limitin dh AK ja ka pranuar atë pikë.

Njëkohësisht na ka pranuar edhe neve trashësinë e medaljes për me thënë se është e drejtë për dy OE-të. Pika tjetër është punimi i medaljes nga OE i rekomanduar për kontratë, ku kemi kërkuar qasje nga zyra prokurimit dhe kemi parë mostrën që ka dorëzuar OE i rekomanduar e cila është e njëjtë "Medalja humanitare nënë Tereza" e që në bazë të ligjit mbi dekoratat decidivisht është e ndaluar të bëhet prodhimi i saj, imitimi apo diçka tjetër, siç kemi cek në ankesë, janë këto dy pika kontestuese të cilat ne kemi bërë ankesën.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-së ka deklaruar: Për het të parë marr pjesë në një panel të këtillë. Kur bëhet fjalë për pikën 3, kur është në pyetje mostra duhet të dimë se 100% nuk bien pasi nuk kemi kërkuar prodhimin, dhe mostra kurrë nuk është 100% në përputhje me

kërkesë. Nëse OE mund të na dëshmoj se ka predispozitat se mund të jetë prodhues, ati i jepet rasti. Nuk desha të caktoj këtë dallim ku përqendrohet OE, për mua si njëri që kam shpall këtë as pika parë nuk ka qenë kriter i eliminimit, mirëpo komisioni ekspertëve kanë thënë se nëse prodhohet medalja me diametër deri 3cm, mundet me 20.0000 ton presione, atëherë prodhohet, mirëpo e njëjta me dimension të dyfishuar me njëjtën teknologji nuk mund të prodhohet, dhe dimensioni këtu luan rol dhe e kanë dhënë si kriter që mundet të jetë eliminues. Dy kritere kanë kërkuar decidivisht, relievi dhe farkimi, këto dy elemente janë qenësore për prodhimin të medaljes dhe nuk mund të bëhet prodhimi. Edhe kriteri 3 dhe 1 për mua nuk kanë qenë eliminues, mirëpo ekspertët për kriterin 1 e kanë vlerësuar si eliminues pasi pa këtë nuk mund të bëhet prodhimi i medaljes. Për dytën, e vërtetë që ka ligj për drejtën e autorit, mirëpo ne nuk kemi gjetur medalje të tillë as në shitje, as në qarkullim dhe askund tjetër, dhe ajo është pranuar vetëm si mostër nga OE.

Nëse ne kërkojmë gjitha medaljet që ka prodhuar ai ndonjëherë, atëherë ato duhet mbuluar shpenzimet për prodhim të tyre ndaj OE.

Kryetari i panelit shqyrtues pyeti përfaqësuesin e AK-së, a i plotëson OE i rekomanduar për kontratë gjitha kushtet dh kriteret e përcaktuara me dosje të tenderit. Në përgjigje përfaqësuesi i autoritetit kontraktues deklaroj: Po absolutisht OE i rekomanduar për kontratë i plotëson gjitha kërkesat e AK-së. Kryetari i panelit pyeti eksperten shqyrtuese se pse keni rekomanduar që të hedhet si e palejuar ankesa e OE ankues dhe pse e keni vlerësuar si palë pa interes material-juridik.

Në përgjigje ekspertja shqyrtuese deklaroj: OE ankues vet në ankesë ka cekur se është palë pa interes material, juridik.

Gjatë prezantimit në seancë ekspertja shqyrtuese ka deklaruar: Lidhur me pretendimin të OE ankues, se OE i rekomanduar ka shkel ligjin për dhënien të dekoratave nga presidenti përkatësisht, neni 16, i sqaroj panelit se kërkesa e AK ka qenë që bashkë me dosjen dhe jeni të obliguar të sjellin një punim me mostër origjinale nga puna juaj, e llojit të njëjtë që të prezantohet mënyra punimit, duhet të jetë me farkim. Andaj OE i rekomanduar për kontratë siç na ka sqaruar përfaqësuesi i AK-së ka pas kontratë të mëhershme me AK-në dhe ka ofruar mostrën duke ju referuar punimit të medaljeve që ka pas kontratë me AK-në.

Ndërsa nëse OE ankues mendon se kjo është e ndaluar me ligj, atëherë ky OE ti drejtohet organeve tjera për këtë çështje pasi që në dosje kërkesa ka qenë në favor të cekur më lart. I propozoj panelit shqyrtues që vendimi i AK të aprovohet dhe ankesa e OE ankues të hedhet si e palejuar pasi që OE ankues është palë pa interes në këtë aktivitet të prokurimit.

Në fjalë përfundimtare përfaqësuesi i OE "Artius Group" deklaroj: Edhe tek eksperti shqyrtues që na paraqiti neve si palë pa interes, nuk mund të jemi ashtu pasi edhe ankesa paguhet dhe kërkojmë drejtësi, që të zhvillohet procedura si a palë pa interes. Ne edhe në ankesë kemi kërkuar anulim të tenderit dhe të përsëritet, pasi edhe arsyet e AK-së janë kundërthënëse kur thotë se nuk është kriter medalja derisa në dosje ka qenë kërkesë. Pastaj, është favorizim i OE të rekomanduar nëse thuhet se ai pavarësisht ligjit, ai favorizohet se paska pas kontratë më herët, dhe tani po mund të paraqes ato medalje, Ne kemi mundur edhe vet me prodhuesin e medaljeve në Maqedoni, të bëjmë një gjë të tillë, mirëpo ai nuk ka pranuar pasi e ka ditur se është shkelje e ligjit. Është shkel ligji për dhënie të dekoratave, janë shkel kriteret e dhënies të kontratës. Andaj ne kërkojmë të shqyrtohet drejtë ankesa jonë dhe nuk do ndalemi deri sa drejtësia nuk bie në vend.

Anëtari i panelit shqyrtues pyeti përfaqësuesin e OE ankues, se a keni pas vërejtje në specifika në fazën e tenderimit. Në përgjigje përfaqësuesi i OE ankues deklaroj: Jo nuk kemi bërë vërejtje në specifika.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-së deklaroj: Prapë po kthehem në të njëjtën gjë, nëse un kam kaluar nga ju si kriter, ne nuk mund të kërkojmë të sjelljet origjinali si kriter. Duhet bërë dallimin mes mostrës dhe prodhimit përfundimtar. OE ankues nuk ka reliev dhe nuk ka farkim pa këtë është e pamundur të realizohet kontrata, dhe është e pamundur të bëhet prodhimi sipas kërkesës së AK-së. Rastin e parë kur kemi pas ankesë dhe vjen mendimi ekspertes, ne kemi reaguar në mendimin e ekspertit, ndërsa në vendimin e OSHP-së është shënuar se AK nuk ka reaguar në mendimin e ekspertit. Ne me dëshmi kemi dërguar në OSHP reagimin tonë me datë të caktuar për mospajtim të AK-së me raportin e ekspertit dhe kemi bërë kërkesë për ndryshim të vendimit. Ne si AK kemi interes të kemi konkurrencë sa më të gjerë në këtë aktivitet. Mirëpo kërkojmë nga paneli shqyrtues të respektohet LPP me rastin vlerësimit, dhe i propozojmë panelit të vërtetoj vendimin e AK-së si të bazuar.

Në fjalën përfundimtare ekspertja shqyrtuese deklaroj: ''Qëndroj në tërësi pranë raportit të ekspertizës, si dhe pranë konstatimeve dhe rekomandimeve të dhëna në raportin e datës. 24.02.2017

Paneli shqyrtues pas analizimit të shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, ekspertizës së ekspertes shqyrtuese, si dhe gjatë deklarimeve të dhëna në seancën dëgjimore, konstaton se OE ankues e ka pranuar në ankesën e tij të dt:03.02.2017 se janë disa arsye të qëndrueshme të eliminimit të tij, çka do të thotë se e ka pranuar që është i papërgjegjshëm, dhe për këtë arsye ka kërkuar anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit. Prandaj duke pasur parasysh faktin se OE ankues është i papërgjegjshëm atëherë rezulton se me rastin e parashtrimit të ankesës ky OE ankues nuk ka mundur të dëshmojë dhe të argumentojë se ka interes juridiko material konform nenit 111 paragrafi 1.5 dhe 1.8 përkitazi me nenin 4 paragrafi 1.26 i LPP-së, pasi që në asnjë variant OE ankues nuk ka mundur të përshkruajë mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme material dhe në asnjë mënyrë nuk mund të shpallet fitues në këtë aktivitet të prokurimit pasi që vetë është i papërgjegjshëm.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në dëshmitë relevante për këtë aktivitet të prokurimit konstaton se kundër njoftimit për kontratë nuk ka pasur asnjë ankesë në lidhje me kriteret apo kërkesat. Ndërsa sa i përket pretendimit tjetër siç pretendon OE ankues, se operatori i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar mostrën siç është kërkuar 3-5 mm, por ka ofruar 5.2 mm, paneli shqyrtues konstaton se mostra është kërkuar të sjellët vetëm si pune e mëparshme e llojit të njëjtë, pasi që veglat për madhësinë e medaljeve janë në pronësi të te zyrës së presidentit, dhe ato i jepen operatorit i cili nënshkruan kontratë me Zyrën e Presidentit për tu punuar medalja, prandaj madhësia e medaljes nuk mund të ndryshojë në këtë rast pasi që punimi i medaljes sa i përket madhësisë bëhet me veglat që janë në pronësi të Zyrës së Presidentit. Kurse e rëndësishme është

përbërja dhe metoda e punimit të medaljeve, e për të vlerësuar këtë në komision të vlerësimit kanë qenë edhe doktor shkence të Kimisë dhe të inxhinierisë mekanike.

Lidhur me pretendimin tjetër te OE ankues, se operatori i rekomanduar "N.T.SH.P Coin"-Prishtinë ka shkelur Ligjin Nr. 04/L070 për dhënien e dekoratave përkatësisht neni 16, ku kërkesë e AK-së ka qenë që të sillet një punim mostër origjinal nga puna e juaj si dhe mënyra e punimit, prandaj paneli shqyrtues konstaton se OE i rekomanduar për kontratë ka vepruar në këtë mënyrë duke ofruar një mostër nga puna e mëparshme e tij. Ndërsa në qoftë operatori ankues mendon sa ka shkelje te ligjit të lartpërmendur dhe se veprimi i OE i rekomanduar për kontratë sanksionohet atëherë është e drejte e tij qe t'ju drejtohet organeve kompetente lidhur me këtë çështje.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Z. Goran Milenkovic

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK "Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës"

1x1 OE "Artius Group" Sh.p.k – Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në Web- faqe të OSHP-së.